



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE

Nr. 121/1 Prot.

Tiranë, më 23.03.2021

**PROGRAMI I TRANSPARENCËS I RISHIKUAR
PËR
INSTITUTIN KOMBËTAR TË TRASHËGIMISË KULTURORE**

I. HYRJE

Në përputhje me nenin 5 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” dhe Urdhrit nr. 187 datë 18.12.2020 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Për miratimin e programit të transparencës të rishikuar”, është përgatitur programi i transparencës i rishikuar për Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore.

Ky program përcakton kornizën ligjore të veprimtarisë së institucionit në kuadër të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” (LDI).

Ky program vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës IKTK ndërton dhe rrit transparencën në punën e tij institucionale, nën garancinë e LDI-së. IKTK-ja do të përditësojë herë pas here Programin e Transparencës, në përputhje me pikën 2 të nenit 5 të LDI-së.

Informacioni i bërë publik në këtë program, synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së IKTK-së, nëpërmjet pasqyrit të detajuar të tij në faqen zyrtare www.iktk.gov.al si dhe në mjediset e pritjes së publikut. Programi i transparencës pasqyrohet në rubrika, tekste/përmbajtje, afat kohor për bërjen publike të tij, mënyrën e bërjes publike si dhe strukturën përkatëse e cila prodhon ose administron dokumentin.

Në përmbajtje të programit të transparencës evidentohet skema e publikimit, e cila pasqyron menutë ku adresohet dokumenti në faqen zyrtare në internet. Përveç kësaj, çdo dokument është i aksesueshëm edhe në skemë.

Dokumentacioni i bërë publik, do të jetë i përditësuar në formë e përmbajtje. Faqja zyrtare e IKTK-së është ndërtuar në atë formë që mundëson informacion për publikun pa kërkesë në format lehtësisht të kuptueshëm. Në rubrikat e faqes zyrtare pasqyrohen edhe informacione që karakterizohen nga kufizime të identifikimit të të dhënave personale për shkak të ruajtjes së privatësisë së individëve/subjekteve të të dhënave, etj.

II. PARIME TË PËRGJITHSHME

Parimet kryesore në të cilat mbështetet Programi Transparencës së IKTK -së janë:

1. “E drejta për informim” është e drejtë Kushtetuese e parashikuar në nenin 23 të saj, e aksesueshme nga të gjithë pa asnjë përjashtim.
2. Prezumimi i publikimit maksimal të të dhënave: IKTK-ja ushtron funksione publike, për rrjedhojë informacioni që rrjedh nga veprimtaria e tij publikohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE

3. Zbatimi korrekt i ligjit dhe dispozitave ligjore që rregullojnë në mënyrë të posaçme veprimtarinë e IKTK-së dhe përkatësisht: Ligji nr. 27, date 17.4.2018 *“Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”*, VKM nr. 364 datë 29.05.2019 për *“Funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore”*, VKM nr. 208 datë 10.4.2019 për *“Përbërjen, mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”*, Ligji nr. 35, datë 31.3.2016 *“Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”*, etj.
4. Informacioni përshtatet në gjuhë të qartë e të kuptueshme.
5. Organ mbikëqyrës i procedurave të informimit publik është Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale” (këtej e tutje KDIMDP).
6. Rishikimi i programit të transparencës bëhet sipas së njëjtës procedurë, përmes së cilës është bërë miratimi i tij.
7. Informacioni publik pa kërkesë duhet të jetë:
 - i plotë;
 - i saktë;
 - i përditësuar;
 - i thjeshtë në konsultim;
 - i kuptueshëm;
 - lehtësisht i aksesueshëm;
 - i pajtueshëm me dokumentet origjinale në posedim të autoritetit publik.

III. INFORMACIONI QË BËHET PUBLIK PA KËRKESË

Informacioni i lejuar për publikim është shprehimisht i parashikuar në nenin 7 të ligjit Nr.119/2014 *“Për të Drejtën e Informimit”*.

Në përputhje me këtë program transparence të miratuar, nga IKTK-ja vendos në dispozicion të publikut në faqen e tij të internetit www.iktk.gov.al, kategoritë e mëposhtme të informacionit:

1. Rreth IKTK:

- Struktura organizative/Organigrama dhe Struktura e pagave të IKTK;
- Funksionet dhe detyrat e IKTK-së;
- CV-të dhe pagat e nënpunësve që janë subjekt deklarimi sipas ligjit, përshkrim të procedurës së zgjedhjes, kompetencat dhe detyrat e tyre;
- Procedura që ndjekin funksionarët e lartë të IKTK-së për të marrë vendime;
- Planet strategjike të punës
- Raporte monitorimi/auditimi të KLSH
- Arkiva (Lista e dokumenteve që administrohen nga IKTK me afatet e ruajtjes dhe Formati i dokumenteve/informacioneve (elektronik, kopje fizike, audio, video, foto)

2. Informacione/dokumente që kërkohen më shpesh dhe ato që gjykohen të dobishme për publikim nga IKTK si Kurse dhe Trajnime, Pasurite Kulturore, Paltforma Webgis,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE

Njoftime të ndryshme, Njoftime për procedurat e rekrutimit, (vendet vakante), Raporte, Publikime, Statistika, Projekte, Bashkëpunime, etj.

3. Legjislacioni

- Legjislacion ndërkombëtar
- Legjislacion kombëtar
- Akte nënligjore për funksionet dhe kompetencat e IKTK
- Rregullore e organizimit dhe funksionimit të IKTK dhe KKTKM
- Kodi i etikes
- Strategjia e Ministrisë së Kulturës
- Raport vjetor për performancën e IKTK
- VKM dhe Udhezime (Manuale/dokument politikash, që ka lidhje me funksionet e IKTK dhe që prek publikun)

4. Programi i Transparencës

- Programi i Transparencës i Rishikuar (dokument i miratuar nga titullari i IKTK)
- Koordinator për të drejtën e informimit/Emri mbiemri, E-mail, Tel; Adresa, Orari
- Format kërkesë / Shpjeguese (Hapat që duhet të ndiqen për të bërë një kërkesë për informim)
- Format ankese / Shpjeguese (Procedurat dhe mekanizmat për të bërë ankese që lidhen me veprimet ose mosveprimet e IKTK (Përfshirë adresën postare/elektronike për depozitim të ankesave - Afatet dhe mënyrën e kthimit të përgjigjeve)
- Regjistri i Kërkesave dhe përgjigjeve të përditësuar (sipas Modelit të Regjistrimit të miratuar nga Komisioneri)
- Buxheti, plani i shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara
- Lista e kontratave të lidhura (përfshirë shumën e kontraktuar, palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve në tabele për çdo vit buxhetor)
- Regjistri i parashikimeve të prokurimit publik (sipas formatit nga Agjencia e Prokurimeve Publike)
- Regjistri i realizimeve të prokurimit publik (sipas formatit nga Agjencia e Prokurimeve Publike)

5. Shërbime

- Lista e Shërbimeve që ofron IKTK nepermjet e-Albania, (përfshirë tarifat përkatëse, formular aplikimi, afati kohor, procedurë ankimimi, standardet për cilësinë e shërbimit)

IV. PUBLIKIMI

Në përputhje me këtë program transparence të miratuar, IKTK-ja vendos në dispozicion të publikut në faqen e tij zyrtare, kategoritë e mësipërme.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE

V. MONITORIMI

Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore monitoron zbatimin e Ligjit nr. 27, datë “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, aktet ligjore dhe nënligjore në zbatim të tij dhe të drejtën e informimit, duke nxitur parimin e transparencës në punën e tij, dhe veçanërisht duke informuar në lidhje me misionin e Institutit dhe vendimet e miratuara nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Arta DOLLANI

